



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 59

19 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 113/2013 datë 11.4.2013	Për aderimin në rezolutën e Bordit të Guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB)..... 2553
Ligj nr. 114/2013 datë 11.4.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 2556
Ligj nr. 115/2013 datë 11.4.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar..... 2557
Vendim i KM nr. 188, datë 6.3.2013	Për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë pyjore “Dhëmbel - Kala”, Përmet, që do të përdoren nga shoqëria “Albanera” sh.p.k., për karrierë guri..... 2558
Udhëzim i MPCSSH nr. 2/1, datë 29.3.2013	Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2, datë 27.2.2013 “Për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të mbrojtjes sociale për vitin 2013”..... 2561
Udhëzim i METE & MF nr. 2, datë 8.2.2013	Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë..... 2562
Urdhër i ILDKPKI nr. 714, datë 3.4.2013	Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar..... 2585

Urdhër i ILDKPKI nr. 715, datë 3.4.2013	Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.....	2586
Vendim i ERRU nr. 14, datë 26.2.2013	Për një shfuqizim në vendimin e KKRR-së nr. 29, datë 28.9.2011 “Për përcaktimin e llogaritjes së sasisë së ujërave të ndotura”	2587
Vendim i ERRU nr. 15, datë 3.4.2013	Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë..	2587
Vendim i ERRU nr. 16, datë 3.4.2013	Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës Tepelenë.....	2588
Vendim i ERRU nr. 17, datë 3.4.2013	Për licencim për herë të parë Ndërmarrja Ujësjiellës Divjakë.....	2588
Vendim i ERRU nr. 18, datë 3.4.2013	Për licencim për herë të parë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Fushë-Krujë.....	2589
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Thoma Prifti.....	2589

LIGJ
Nr. 113/2013

**PËR ADERIMIN NË REZOLUTËN E BORDIT TË GUVERNATORËVE
TË BANKËS SË DETIT TË ZI PËR TREGTI DHE ZHVILLIM (BSTDB)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Aderimin në rezolutën nr. 99, datë 5 tetor 2008, të Bordit të Guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB) “Nënshkrimi për rritjen e kapitalit të autorizuar të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim”.

Neni 2

Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, rregullat dhe autoritetin kompetent për realizimin e rritjes së aksioneve të Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8103, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

REZOLUTË E BORDIT TË GUVERNATORËVE
REZOLUTA NR. 99

Lënda: Nënshkrim për rritjen e kapitalit të autorizuar të BSTDB-së

Bordi i Guvernatorëve vëren shënimin e “Raport mbi nënshkrimin për aksionet e pacaktuara dhe rritjen e kapitalit të BSTDB -së”.

Bordi i Guvernatorëve vendos që:

A. Nga rritja në kapitalin e autorizuar të BSTDB-së prej dy miliardë SDR (SDR 2.000.000.000), shuma e ofruar për nënshkrim caktohet një miliard SDR (SDR 1.000.000.000) të ndarë në një milion (1.000.000) aksione që kanë një vlerë nominale prej një mijë SDR (SDR 1.000) secili.

Rritja e kapitalit prej 1 miliard SDR ndahet në 300 milionë SDR kapital i paguar dhe SDR 700 milionë kapital të kërkueshëm, si më poshtë:

- 300 milionë SDR pjesë e paguar (30%) e rritjes së nënshkruar dhe të përcaktuar në kapital ndahet si më poshtë:



i) dhjetë për qind (10%) aksione të paguara tërësisht; dhe
ii) njëzet për qind (20%) aksione të pagueshme, pagesa e të cilave bëhet nga letër-pretime të panegociueshme dhe që nuk gjenerojnë interes, apo detyrim i ngjashëm të lëshuar nga shtetet anëtare dhe që përcaktohen në SDR.

- 700 milionë SDR pjesë e kërkueshme (70%) e rritjes së nënshkruar dhe të përcaktuar të kapitalit është i pagueshëm kur kërkohet në pajtim me paragrafin 4 të nenit 6 të marrëveshjes themeluese të BSTDB-së.

B. Duke pasur parasysh që Gjeorgjia nuk nënshkroi për rritjen në kapital, BoG (Bordi i Guvernatorëve) autorizon caktimin e 10,000 aksioneve të barasvlershme me një (1) për qind të rritjes së kapitalit të ofruar për nënshkrim Rumanisë dhe mbyll fazën e 1-rë të regjistrimit.

C. Duke pasur parasysh nënshkrimet e paraqitura nga shtetet anëtare në letrat e angazhimit dhe të marra nga BSTDB-ja para datës 15 shtator 2008, BoG vendos t'u shpërndajë shteteve anëtare numrin e mëposhtëm të aksioneve nga rritja e stokut të kapitalit të BSTDB-së dhe mbyll fazën e 2-të të regjistrimit:

- Republika e Shqipërisë - ka nënshkruar dhe i jepen 20 000 aksione, që përfaqësojnë 2 për qind;

- Republika e Armenisë - ka nënshkruar dhe i jepen 10 000 aksione, që përfaqësojnë 1 për qind;

- Republika e Azerbajxhanit - ka nënshkruar dhe i jepen 50 000 aksione, që përfaqësojnë 5 për qind;

- Republika e Bullgarisë - ka nënshkruar dhe i jepen 135 000 aksione, që përfaqësojnë 13,5 për qind;

- Gjeorgjia - nuk ka nënshkruar;

- Republika Greke - ka nënshkruar dhe i jepen 165 000 aksione, që përfaqësojnë 16,5 për qind;

- Republika e Moldavisë - ka nënshkruar dhe i jepen 10 000 aksione, që përfaqësojnë 1 për qind;

- Rumania - ka nënshkruar 195 000 aksione nga rritja në kapitalin e BSTDB-së dhe i jepen 145 000 aksione, të barabarta me 135 000 aksione – raporti që stoku i saj i nënshkruar ka me totalin e stokut të kapitalit të nënshkruar menjëherë para rritjes së kapitalit – plus 10 000 aksione të mbetura pa u nënshkruar dhe të deklaruara të disponueshme për ndarje, që përfaqësojnë 14,5 për qind;

- Federata Ruse - ka nënshkruar dhe i jepen 165 000 aksione, që përfaqësojnë 16,5 për qind;

- Republika e Turqisë - ka nënshkruar dhe i jepen 165 000 aksione nga rritja e kapitalit të BSTDB-së, që përfaqësojnë 16,5 për qind;

- Ukraina - ka nënshkruar dhe i jepen 135 000 aksione nga rritja e kapitalit të BSTDB-së, që përfaqësojnë 13,5 për qind.

D. Shtetet anëtare do t'i paguajnë Bankës pjesën e pagueshme të rritjes së përcaktuar në kapitalin e BSTDB-së si më poshtë:

- pagesa e parë prej 10% (aksione të paguara plotësisht) të aksioneve të caktuara në vitin 2010; dhe

- pjesa e mbetur prej 20% të aksioneve të caktuara (aksione të pagueshme) në tetë këste të barabarta të njëpasnjëshme vjetore, i pari më 2011-ën dhe i fundit më 2018-ën.

Vlera e secilës pagesë faktike është shuma e përcaktuar në USD ose euro e barasvlershme me shumën në SDR të kërkueshme për çdo pagesë, të konvertuar nga shteti(et) anëtar pagues, duke përdorur normën e këmbimit zyrtare të SDR-së, siç komunikohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ditën menjëherë para datës së pagesës; data e pagesës është datë e vlerës dhe, gjithashtu, data e transfertës të shumës së kërkueshme në llogarinë e BSTDB-së.

E. Pas rritjes në stokun e kapitalit të BSTDB-së

1. Stoku i përgjithshëm i kapitalit të autorizuar të Bankës është tre miliardë SDR (SDR

3.000.000.000), të ndarë në tre milionë (3.000.000) aksione që kanë një vlerë nominale prej një mijë SDR (SDR 1.000) secili.

2. Shuma e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar të Bankës është dy miliardë SDR (SDR 2.000.000.000), të ndarë në dy milionë (2.000.000) aksione që kanë një vlerë nominale prej një mijë SDR (SDR 1.000) secili.

3. Numri i aksioneve të nënshkruara nga çdo anëtar dhe përqindja e stokut të përgjithshëm të kapitalit të nënshkruar dhe të autorizuar të Bankës që mbahet nga secili anëtar, është si më poshtë:

Republika e Shqipërisë – 40.000 aksione (SDR 40.000.000, vlera nominale e plotë) – dy (2) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe një për qind dhe një e treta e një për qind (1.34) e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Republika e Armenisë – 20.000 aksione (SDR 20.000.000, vlera nominale e plotë) – një (1) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe dy e treta (0.67) e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Republika e Azerbajxhanit – 100.000 aksione (SDR 100.000.000, vlera nominale e plotë) – pesë (5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe tre për qind dhe një e treta e një për qind (3.34) e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Republika e Bullgarisë – 270.000 aksione (SDR 270.000.000, vlera nominale e plotë) – trembëdhjetë pikë pesë (13.5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe nëntë (9) për qind e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Republika e Gjeorgjisë – 10.000 aksione (SDR 10.000.000, vlera nominale e plotë) – gjysmë (0.5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe një e treta (0.34) e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Republika e Greqisë – 330.000 aksione (SDR 330.000.000, vlera nominale e plotë) – gjashtëmbëdhjetë pikë pesë (16.5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe njëmbëdhjetë (11) për qind e stokut të kapitalit të autorizuar të bankës;

Republika e Moldavisë – 20.000 aksione (SDR 20.000.000, vlera nominale e plotë) – një (1) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës, dhe dy e treta (0.67) për qind e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Rumania – 280.000 aksione (SDR 280.000.000, vlera nominale e potë) – katërmbëdhjetë (14) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe nëntë për qind, dhe një e treta për qind (9.34) e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Federata Ruse – 330.000 aksione (SDR 330.000.000 vlera nominale e plotë) – gjashtëmbëdhjetë pikë pesë (16.5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe njëmbëdhjetë (11) për qind e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Republika e Turqisë – 330.000 aksione (SDR 330.000.000, vlera nominale e plotë) – gjashtëmbëdhjetë pikë pesë (16.5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe njëmbëdhjetë (11) për qind e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës;

Ukraina – 270.000 aksione (SDR 270.000.000 vlera nominale e plotë) – trembëdhjetë pikë pesë (13.5) për qind e kapitalit të nënshkruar të Bankës dhe nëntë (9) për qind e stokut të kapitalit të autorizuar të Bankës.

F. Bordi i Guvernatorëve autorizon Presidentin e BSTDB-së t'u komunikojë autoriteteve përkatëse të shteteve anëtare rezultatet e rritjes në kapitalin e autorizuar dhe të nënshkruar të BSTDB-së dhe strukturën e re të pjesëve të aksioneve. Në pajtim me këtë rezolutë, shtetet anëtare ftohen të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pagesa e aksioneve të ndara të kryhet në pajtim me grafikun e paraqitur te pika D më sipër.

Miratuar më 5 tetor 2008 në mbledhjen e 6-të të veçantë të Bordit të Guvernatorëve.



LIGJ
Nr. 114/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9877, DATË 18.2.2008 “PËR ORGANIZIMIN E
PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “a” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë

1. Paga për funksion e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

3. Paga për funksion e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Paga për funksion e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta të punës, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

5. Masa e shtesës për vjetërsi shërbimi, shtesës për kushte të veçanta pune dhe shtesës për drejtimin e gjykatës llogariten mbi pagën për funksion.”.

Neni 2

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së apelit

1. Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 75 për qind të pagës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

3. Paga për funksion e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Paga për funksion e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe e kryetarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta të punës, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

5. Masa e shtesës për vjetërsi shërbimi, shtesës për kushte të veçanta pune dhe shtesës për drejtimin e gjykatës llogariten mbi pagën për funksion.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1.1.2014 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8104, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 115/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9584, DATË 17.7.2006 “PËR
PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA
KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA
ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 pika 1, fjalët “Avokati i Prokurimeve” hiqen dhe shtohen fjalët “Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Neni 2

Në klasifikimin “D” të lidhjes nr. 1, që përmendet në nenin 4, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 0,6;”.

2. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi 0,6.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe për komisionerët e përmendur në nenin 1 të këtij ligji i shtrin efektet financiare nga data e emërimit në detyrë.

Miratuar në datën 11.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8105, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 188, datë 6.3.2013

**PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E
EKONOMISË PYJORE “DHËMBEL - KALA”, PËRMET, QË DO TË PËRDOREN NGA
SHOQËRIA “ALBANERA” SHPK, PËR KARRIERË GURI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit të Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar dhe çregjistrimin nga zëri kadastral “pyll” të sipërfaqes prej 7.5 (shtatë pikë pesë) ha, pjesë e ngastrës 39/a të ekonomisë pyjore “Dhëmbel - Kala”, që do të përdoret nga subjekti “Albanera” sh.p.k., për karrierë guri, sipas hartës përkatëse që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Heqja nga fondi pyjor dhe dhënia në përdorim subjektit “Albanera” sh.p.k., të bëhet me pjesë, sipas madhësisë së sipërfaqes të miratuar në planin vjetor të punimeve të parashikuara në projekt.

3. Subjekti “Albanera” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim sipas kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi. Të ndërpritet dhënia në përdorim e pjesës tjetër dhe vazhdimi i punimeve në vitin pasardhës, në qoftë se subjekti “Albanera” sh.p.k., nuk ka rehabilituar sipërfaqen e shfrytëzuar në vitin paraardhës.

4. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të Fondit Pyjor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në sipërfaqe inproduktive për veprimtari minerare, në zbatim të pikave 9 dhe 10 të vendimit nr. 1353, datë 10.10.2008 të Këshillit Ministrave “Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

5. Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe e infrastrukturës së saj, paguhet nga subjekti “Albanera” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, bashkëlidhur vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, subjekti “Albanera” sh.p.k., brenda 2 (dy) viteve, me fondet e veta, do të pyllëzojë 7.5 (shtatë pikë pesë) ha në ngastrat e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore, Këlcyrë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Përmet. Mënyra e pyllëzimit, deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar të bëhet sipas marrëveshjes, që lidhet ndërmjet palëve me kërkuesin.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësia përkatëse e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




HARTA TOPOGRAFIKE ME ZONEN E KERKUAR

Subjekti "Albanera" shpk

Nomenklatura K-34-137-A-b

SH: 1:10,000



UDHËZIM
Nr. 2/1, datë 29.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA NR. 2, DATË 27.2.2013 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË MBROJTJES SOCIALE PËR VITIN 2013”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, si dhe pikës 29/c të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 19.2.2013 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2, datë 27.2.2013 “Për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të mbrojtjes sociale për vitin 2013”, bëhen ndryshimet:

1. Pika 1/d riformulohet si më poshtë vijon:

d) “Financimin në zërin shpenzime korente të qendrave të përkujdesit social, të transferuara, me qëllim funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të tyre për sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore për qendrat e përkujdesit shoqëror, të transferuara”.

2. Në pikën 13, shprehja “... transfertë e kushtëzuar në njësitë e qeverisjes vendore...”, zëvendësohet me shprehjen “...shpenzime korente në qendrat e përkujdesit shoqëror të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore...”.

3. Pika 13 e dyta, bëhet pika 14 dhe në këtë pikë ndryshohet shprehja “njësitë e qeverisjes vendore...” zëvendësohet me shprehjen “qendrat e përkujdesit shoqëror, të transferuara...”.

4. Pika 14 bëhet pika 15 dhe në këtë pikë, pas shprehjes “njësitë e qeverisjes vendore” shtohet shprehja “dhe qendrat e përkujdesit shoqëror, të transferuara...”.

5. Pika 15 hiqet.

6. Kudo në udhëzim që përdoret shprehja “qendrat e përkujdesit shoqëror”, shtohet fjala “të transferuara”.

7. Në pikën 16, baza ligjore “... ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” zëvendësohet me “... ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe “Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2/1, datë 15.2.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012” zëvendësohet me “Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 19.2.2013 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA**
Spiro Ksera



UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.2.2013

**PËR TARIFAT DHE PAGESAT E SHËRBIMEVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 63 të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale në Ministrinë e Financave; Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Personat fizikë ose juridikë, që prodhojnë, importojnë ose përdorin instrumente matëse për shërbimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) për llogari të tyre, janë të detyruar të paguajnë vlerat financiare, që llogariten bazuar në tarifën e përcaktuar sipas pikave të këtij udhëzimi, si dhe përcaktimet që jepen nga pasqyra nr. 1 deri në pasqyrën nr. 7, të cilat janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.

2. Për miratimin e tipit të instrumentit matës ose për njohjen e miratimit të tipit të instrumenteve matëse që importohen, përdoren tarifën e përcaktuar në pasqyrën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.1 Nëse tipi i instrumentit matës, të paraqitur për miratim, nuk përputhet me kërkesat teknike-metrologjike, procedura e punës ndërpritet dhe subjekti paguan tarifën e shënuar në germën “a” dhe gjysmën e tarifës së shënuar në germën “b” të pikës 1 të pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.2 Tarifën e miratimit të tipit paguhet edhe kur tipi i instrumentit matës në përfundim nuk plotëson kërkesat për miratim.

2.3 Kur importohen instrumente matëse, zbatohen tarifën e përcaktuar në pikën 2 të pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Për regjistrimin e instrumenteve matëse zbatohen tarifën e përcaktuar në pasqyrën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Për verifikimin periodik të instrumenteve matëse ligjore zbatohen tarifën si vijon:

4.1 Kur shërbimi i verifikimit të instrumenteve matëse kryhet në laboratorët e DPM-së, laboratorët e sektorëve të shërbimit, si dhe në autolaboratorët e lëvizshëm, kur këta përdoren si stacionarë (pranë ambienteve të bashkive dhe komunave), zbatohen tarifën e dhëna në pasqyrën nr. 3.

4.2 Kur shërbimi i verifikimit të instrumenteve matëse kryhet në vendpërdorimin (në ambientet e subjektit përdorues) e instrumentit matës, do të zbatohen tarifën e dhëna në pasqyrën nr. 3/1.

5. Për verifikimin fillestar të instrumenteve matëse do të paguhet tarifën sa dyfishi i tarifave për verifikimin periodik (të dhëna në pasqyrën nr. 3 ose në pasqyrën nr. 3/1).

6. Për kalibrimin e instrumenteve matëse zbatohen tarifën e përcaktuar në pasqyrën nr. 4 dhe 4/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6.1 Për rastet kur kërkohet kopje (dublikatë) e certifikatës/raportit të kalibrimit, paguhet vlera fikse prej 500 lekësh.

7. Pagesat e verifikimit fillestar ose periodik, si dhe pagesat e kalibrimit llogariten për copë, për çdo pronar ose administrues të marrë veç e veç, si dhe për instrumente matëse të të njëjtit tip dhe që verifikohen ose kalibrohen në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë.

8. Kur sasia e instrumenteve matëse të të njëjtit tip, që verifikohet ose kalibrohet është më e madhe se një copë, pagesa llogaritet nga produkti i pagesës përkatëse për copë me numrin e copëve të këtij tipi instrumenti matës, kur nuk paraqitet ndryshe në pasqyrën përkatëse.

9. Kur puna verifikuese ndërpritet për shkak të pronarit ose administruesit të instrumentit matës, pagesa për copë llogaritet mbi bazën e numrit të instrumenteve matëse, që janë verifikuar faktikisht nga ai tip deri në momentin e ndërprerjes. Kur gjatë verifikimit, instrumenti matës nuk u përgjigjet kërkesave teknike dhe metrologjike ligjore, ai bllokohet për mospërdorim dhe nga subjekti paguhet gjysma e pagesës së përcaktuar sipas pasqyrave nr. 3 dhe nr. 3/1, që i bashkëngjiten këtij udhëzimi, si dhe shpenzimet përkatëse të transportit për rastet që parashikohen në këtë udhëzim (nënpika 10.1).

10. Personi fizik ose juridik që kërkon të kryejë verifikimin e instrumenteve matëse që disponon në vendpërdorimin e tyre, përballon dhe shpenzimet shtesë të mëposhtme:

10.1 Për peshoret hekurudhore, automobilistike dhe ato me platformë për transportin e bazës etalonuese:

i) për largësi të vendndodhjes së peshores, që verifikohet deri 40 km nga DPM-ja shpenzimet shtesë merren në vlerë fikse prej 5 000 lekësh;

ii) për largësi të vendndodhjes së peshores (që verifikohet ose kalibrohet) mbi 40 km, shpenzimet shtesë përcaktohen nga produkti i largësisë në “km” i vendndodhjes së saj nga DPM-ja, me tarifën 140 lekë/km;

iii) për peshoret e kapacitetit të madh (40 tonë e sipër) pronari/administruesi duhet të sigurojë ngarkesën zëvendësuese përkatëse.

10.2 Për vagoncisternat, autobotet dhe rezervuarët:

a) materialet e nevojshme ndihmëse;

b) pagesën për shfrytëzimin e peshores së përdorur për verifikim.

11. Për shërbimet për produktet e parapaketuara paguhet tarifat sipas pasqyrës nr. 5 të këtij udhëzimi.

12. Për kryerjen e procedurave të autorizimit të subjekteve, që kryejnë shërbime në fushën e metrologjisë ligjore, si dhe të monitorimit periodik të tyre, aplikohen tarifat e përcaktuara në pasqyrën nr. 6 të këtij udhëzimi.

13. Për pjesëmarrje në kurse trajnimi teorike dhe teoriko-praktike, që ofrohen nga DPM-ja, do të paguhet tarifat e paraqitura në pasqyrën nr. 7.

14. Për shërbimet, të cilat nuk përfshihen në pasqyrat bashkëngjitur, tarifa ose pagesa do të përlllogaritet me kohën e punës në orë, të nevojshme për shërbimin e kryer, shumëzuar me tarifën 1 500 lekë.

15. Në faturën tatimore që i lëshohet subjektit për shërbimin e kryer nga DPM-ja, tarifave dhe pagesave të dhëna në pasqyrat bashkëlidhur këtij udhëzimi i shtohet vlera përkatëse e TVSH-së.

16. Udhëzimi ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Financave: nr. 7643/3, datë 8.12.2009 dhe nr. 11961/3, datë 11.12.2009 “Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

17. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode



Pasqyra Nr.1

**TARIFAT PËR PROCEDURAT E MIRATIMIT TË TIPIT (NJOHJES) TË
INSTRUMENTIT MATËS**

1. Për prodhimin në vend të instrumenteve matëse

a) Për shqyrtimin dhe pranimin e dokumentave për miratimin e tipit:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (ne Leke)</i>
1	Instrumenta matëse	5 000 leke
2	Për sisteme matëse	10 000 leke

b) Për verifikimin e treguesve teknikë dhe metrologjikë të tipit paguhet sa dyfishi i vlerës së përcaktuar në pasqyrën nr.3 të këtij vendimi. Për raste kur instrumenti matës nuk është i cilësuar në pasqyrën nr.3, bashkangjitur këtij udhëzimi, pagesa bëhet në zbatim të pikës 14 të udhëzimit.

c) Për shpalljen e miratimit të tipit ose njohjes së miratimit të tipit :

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (ne Leke)</i>
1	Për çdo faqe të daktilografuar	83 lekë
2	Për çdo skemë	167 lekë
3	Për çdo fotografim	417 lekë

d) Nëse mostra e paraqitur nuk përputhet me kërkesat teknike të përcaktuara, procedura e punës ndërpritet dhe subjekti paguan tarifën e pikës “a” dhe gjysmën e tarifës së pikës “b”.

2. Per instrumentet matëse të importuara

a) Për shqyrtimin e dokumentacionit të miratimit të tipit:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (ne Leke)</i>
1	Instrumenta matëse	5 000 leke
2	Për sisteme matëse	10 000 leke

b) Kur është e nevojshme kryerja e testeve për verifikimin e përmbushjes së treguesve teknikë dhe metrologjikë të tipit paguhet sa dyfishi i vlerës së përcaktuar në pasqyrën nr.3 të këtij vendimi. Për raste kur instrumenti matës nuk është i cilësuar në pasqyrën nr.3, bashkangjitur këtij udhëzimi, pagesa behet në zbatim të pikës 14 të udhëzimit.

Pasqyra Nr.2

TARIFAT E REGJISTRIMIT TE INSTRUMENTEVE MATESE LIGJORE

1. Regjistrimi i instrumenteve matëse

<i>Nr.</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (ne Leke)</i>
<i>1</i>	Për çdo instrument matës	85 lekë
<i>2</i>	Për gramare ose masa vëllimore seri, deri në 5 cope	85 lekë
<i>3</i>	Për çdo gramar ose mase vëllimore shitesë	40 lekë



Pasqyra Nr.3

**TARIFAT PER VERIFIKIM PERIODIK TE INSTRUMENTAVE MATES LIGJORE NE
LABORATORET E DPM DHE TE SEKTOREVE TE SHERBIMIT**

1. Matësit material të gjatësisë

1.1. Metra

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Metër deri në 1 m	580
2	Metër mbi 1 m	800

1.2. Metra shirit

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Meter shirit deri ne 5 m	1000
2	Meter shirit mbi 5 m deri 50 m	2500
3	Meter shirit mbi 50m	6250

1.3. Për sasi mbi 5 cope instrumente matëse të pikave 1.1 dhe 1.2 bëhet zbritja si më poshtë:

nga 6 copë deri në 10 copë	10%
mbi 10 copë	20 %

2. Masa vëllimore për lëngje në të cilat është shënuar kufiri i vëllimit ose është caktuar kapaciteti deri në buzë (përfshirë masat e kapacitetit të shërbimit)

Verifikim vëllimi

<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	nga 1 dm ³	deri në 5	290
		6 deri 10	270
		mbi 10 deri 100	250
2	mbi 1 dm ³ deri ne 5 dm ³	deri në 5 cope	380
		6 deri 10 cope	340
		mbi 10 cope	290
3	mbi 5 dm ³ deri 10 dm ³	deri në 5 cope	580
		6 deri 10 cope	500
		mbi 10 cope	420
4	mbi 10 dm ³ deri 20 dm ³	deri në 5 cope	840
		6 deri 10 cope	670
		mbi 10 cope	580
5	mbi 20 dm ³ deri 50 dm ³	deri në 5 cope	1 350
		6 deri 10 cope	1 170
		mbi 10 cope	840
6	mbi 50 dm ³ deri 100 dm ³	deri në 5 cope	1 670
		6 deri 10 cope	1 500
		mbi 10 cope	1 340

3. Masa vëllimore qelqi dhe porcelani me vëllim deri në 5 dm³

Nr	Përshkrimi	Sasia	Tarifa (në Leke)
1	1 dm ³	deri në 5 cope	420
		6 deri 10 cope	340
		mbi 10 deri 100 cope	250
2	mbi 1 dm ³ deri 5 dm ³	deri në 5 cope	500
		6 deri 10 cope	420
		mbi 10 cope	340

Për masa qelqi jo të tejdukshme dhe porcelani, pagesa e verifikimit të tyre është sa dyfishi i atyre të vendosura në këtë pikë.

4. Verifikim mase kapaciteti shërbimi

Nr	Emërtesa	Tarifa (në Leke)
1	Mase kapaciteti 10 ml deri ne 100 ml	580
2	Mase kapaciteti 100 ml deri ne 5 l (disa nen-ndarje)	1 080

5. Masa vëllimore si voza, damixhane, shishe me vëllim mbi 5 dm³, rezervuare, autobot, (vagonçistern).

5.1. Voza, damixhane, shishe, rezervuare.
Verifikim vëllimi

Nr	Emërtesa	Tarifa (në Leke)
1	deri 50 dm ³	1 250
2	mbi 50 dm ³ deri 100 dm ³	1 500

5.2 Për verifikimin e enëve vëllimore me shumë nëndarje të veçanta, kur verifikimi i nëndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, pagesës për kapacitet të plotë të enës vëllimore i shtohet pagesa prej 50 % për verifikimin e vëllimit përkatës të çdo nëndarje.

6. Gramare në përputhje me R111(2004) të OIML

6.1. Klasa M₃

Nr	Emërtesa	Tarifa (në Leke)
1	1 g deri 200 g	100
2	mbi 200g deri ne 5kg	280
3	10 kg	650
4	20 kg	820
5	50 kg	1 000
6	500 kg	2 700
7	1000 kg	4 200



6.2. Gramare, klasa e saktësisë M_1 dhe M_2 (klasa M_2 duke filluar nga 100mg)

Për verifikimin e gramareve të klasave M_1 dhe M_2 pagohet dyfishi i pagesës përkatëse të dhënë në pikën 6.1.

6.3 Gramare klasa F2

Për verifikimin e gramarëve të klasës F2 pagesa është sa trefishi i dhënë në pikën 6.1 (klasa F2 deri 50 kg)

6.4 Gramare jo në përputhje me R111(2004) të OIML dhe gramarë me masë nominale të lire.

Për verifikimin e gramarëve jo në përputhje me R111(2004) të OIML dhe gramarë me masë nominale të lire, tarifa është dyfishi i pagesës përkatëse të dhënë në pikën 6.1.

7. Peshore

7.1. Peshore jo-automatike klasa II

<i>Nr.</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Peshore jo-automatike (kl II) deri 35 kg	3 650
2	Peshore jo-automatike (kl II) mbi 35 kg deri 150 kg	5 000

7.2. Peshore jo-automatike mekanike (klasa III)

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	deri 1 kg	680
2	mbi 1 kg deri 35 kg:	1 200
3	mbi 35 kg deri 150 kg	3 500

7.3. Peshore jo automatike elektronike, klasa III

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	deri 1 kg	1 000
2	mbi 1 kg deri 35 kg:	1 500
3	mbi 35 kg deri 150 kg	3 500
4	mbi 150 kg deri 1500 kg	7 700

8. Instrumente matës të fushës të presionit

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Matësit e presionit të gomave të automjeteve	600
2	Manometra	1 600

9. Taksimetra

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Taksimeter	2 500

10. Radare të matjes së shpejtësisë

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Parimi Doppler	18 250
2	Parimi Lazer	8 280

11. Analizuesit e alkoolit në frymën e drejtuesve të automjeteve

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Tarifa (në Leke)</i>
1	Analizues i sasisë së alkoolit në frymëmarrjen e drejtuesve të automjeteve	8500

12. Aparate matës elektrik

<i>Nr</i>	<i>Emërtesa</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Leke për cope</i>
1	Kontatorë të energjisë elektrike një fazor, me klasë saktësie 3, 2 dhe 1	Një tarifor	1 200
		Dy tarifor	1 500
		Shumë tarifor	1 800
2	Kontatorë të energjisë elektrike shumë fazor, me klasë saktësie 3, 2 dhe 1	Një tarifor	1 500
		Dy tarifor	1 800
		Shumë tarifor	2 100
3	Njehsorë elektrik të klasës së saktësisë 0.5 e më të mirë,	Për veprim njëkahor	4 000
		Për veprim dy kahor	5 500
		Për veprim dy kahor aktiv dhe reaktiv	7 000



Pas qyra Nr.3/1

**TARIFAT PER VERIFIKIM PERIODIK TE INSTRUMENTAVE MATES LIGJORE NE
VENDPERDORIM (PRANE SUBJEKTIT)**

1. Matësit material të gjatësisë

1.1 Metra

Nr	Emërtesa	Leke për cope
1	Metër deri në 1 m	700
2	Metër mbi 1 m	960

1.2 Metra shirit

Nr	Emërtesa	Leke për cope
1	deri në 5 m	1 200

1.3. Për sasi mbi 5 cope instrumente matëse të pikave 1.1 dhe 1.2 bëhet zbritja si më poshtë:

nga 6 copë deri në 10 copë	10%
mbi 10 copë	20 %

2. Masa vëllimore për lende të thata, vëllimi i të cilave del me përllogaritje

Nr	Emërtesa	Leke për cope
1	Masë vëllimore	2 500
2	një nënndarje e masës vëllimore	1 250
3	çdo nënndarje tjetër shtesë	850

3. Masa vëllimore për lëngje në të cilat është shënuar kufiri i vëllimit ose është caktuar kapaciteti deri në buze (përfshire masat e kapacitetit të shërbimit)

3.1 Verifikim vëllimi

Nr	Përshkrimi	Sasia	Leke për cope
1	nga 1 dm ³	deri në 5	350
		6 deri 10	320
		mbi 10 deri 100	300
2	mbi 1 dm ³ deri ne 5 dm ³	deri në 5 copë	450
		6 deri 10 copë	400
		mbi 10 copë	350
3	mbi 5 dm ³ deri 10 dm ³	deri në 5 copë	700
		6 deri 10 copë	600
		mbi 10 copë	500

4	mbi 10 dm ³ deri 20 dm ³	deri në 5 copë	1000
		6 deri 10 copë	800
		mbi 10 copë	700
5	mbi 20 dm ³ deri 50 dm ³	deri në 5 copë	1600
		6 deri 10 copë	1400
		mbi 10 copë	1000
6	mbi 50 dm ³ deri 100 dm ³	deri në 5 copë	2000
		6 deri 10 copë	1800
		mbi 10 copë	1600

4. Masa vëllimore qelqi dhe porcelani me vëllim deri në 5 dm³

Nr	Përshkrimi	Sasia	Leke per cope
1	1 dm ³	deri në 5 cope	500
